

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të neneve 42 dhe 63 të Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e në lidhje me zbatimin e nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat, (Gazetat Zyrtare e RM-së nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe 96/19), në seancën e mbajtur më 04.02.2025, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa për përcaktimin e qëndrimit parimor ose mendimit juridik parimor e parashtuar nga avokati Risto Novakovski nga Ohri, nga Shoqëria e avokatëve Goxho, Kiçeec dhe Novakovski nga Ohri, regjistruar nën Su-03 nr.747/24 të datës 12.11.2024, NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është parashtuar Iniciativë për përcaktimin e qëndrimit parimor ose mendimit juridik parimor nga avokati Risto Novakovski nga Ohri, nga Shoqëria e avokatëve Goxho, Kiçeec dhe Novakovski nga Ohri.

Në iniciativë, parashtuesi avokat Risto Novakovski nga Ohri, duke iu referuar nenit 12 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Amendamentit III të Kushtetutës së RMV-së, nenit 37 paragrafit (1) pikës 1 të Ligjit për gjykatat dhe nenit 63 të Rregullores së nr. në kapitullin e XIV, në 24 faqe, kërkon që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të sjellë mendim juridik parimor ose qëndrim parimor me të cilin do të vërtetohet se:

“Në kohëzgjatjen maksimale të paraburgimit prej dy vitesh pas plotfuqishmërisë së Aktakuzës, llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim të caktuar deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit të shkallës së parë, si dhe koha e kaluar në burg në bazë të aktgjykimit të formës së prerë e cila më vonë është shfuqizuar.”

Si bazë për iniciativën, theksohet procedura e cila ka qenë në fazën e seancës kryesore që është zhvilluar për herë të tretë, sepse aktgjykimet paraprakisht të sjella të Gjykatës Themelore të Ohrit të vërtetuara me aktgjykim të Gjykatës së Apelit Manastir, janë abroguar me aktgjykim të Gjykatës Supreme të RMV-së dhe lënda është kthyer në ri vendimmarrje në Gjykatën e shkallës së parë dhe që kjo ka udhëzuar që procedura penale është në fazën e seancës kryesore. Duke marrë parasysh të lartë përmendurën, parashtuesi i iniciativës jep kronologji për ngjarjet e lëndës konkrete.

Në shtojcë të iniciativës janë dorëzuar dokumente lidhur me kronologjinë e ngjarjeve për këtë lëndë konkrete, si dhe aktvendime në lidhje me paraburgimin, që kanë të bëjnë me lëndën konkrete të përfshirë në iniciativë.

Sipas nenit 37 paragrafi (1) të Ligjit për gjykatat, Gjykata Supreme e RMV-së, përcakton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore për çështje të rëndësishme

për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tre muajsh, por jo më tepër se gjashtë muaj me vetiniciativë ose me iniciativë së kryetarit të gjykatës ose me iniciativë të seancave të gjyqtarëve ose departamenteve gjyqësore të gjykatave ose me iniciativë së seancave të avokatëve dhe i publikojnë në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Sipas nenit 63 të Rregullores së Gjykatës Supreme, Seanca gjyqësore përcakton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore për çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat. Qëndrimi parimor paraqet qëndrim të cilin e përcakton Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat. Mendimi juridik parimor është qëndrim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështje të caktuar, për të cilën në seancën e përgjithshme është marrë qëndrim për shkak të praktikës së pabarabartë në zbatimin e ligjeve.

Duke qenë se iniciativa e parashtruar dhe shtojcat e dorëzuara nuk tregojnë praktikë të ndryshme gjyqësore dhe pabarazi në zbatimin e ligjeve nga gjykatat, nga të cilat do të rezultonte nevoja për përcaktimin e një qëndrimi parimor ose mendimit juridik parimor për çështje juridike dhe nuk ekziston praktikë e pabarabartë gjyqësore, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nxori Konkluzion me të cilin nuk u miratua Iniciativa për përcaktimin e mendimit juridik parimor ose qëndrimit parimor, të parashtruar nga avokati Risto Novakovski nga Ohri, nga Shoqëria e avokatëve Goxho, Kiçeec dhe Novakovski nga Ohri, regjistruar nën Su-03 nr.747/24 të datës 12.11.2024.

**Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme
të Republikës së Maqedonisë së Veriut**